Sabit Abdyli

Sunday, 22 June 2014

Nga libri ditar “Ankthi i Pranverës ‘99”, Prishtinë, 2004, Sabit Abdyli - Fshati Lubishtë

Me datën 5 prill, rreth orës 13.00, të mesditës, mbi 400 paramilitarë e ushtarakë serbë, të verbuar nga urrejtja, ndërmorën një aksion ndëshkues kundër fshatit Lugishtë (ish Lubishtë). Sulmi ishte i përgatitur paraprakisht deri në detaje. Po atë ditë, u sulmua edhe fshati Smirë. Së pari u granatua prej së largu, fshati. U godit shtëpia e Fetah Etemit. Forcat serbe që më parë ishin stacionuar rreth fshatit, u futën me tanksa dhe pas tyre këmbësoria, duke goditur me armë zjarri për vdekje shumë civilë. Në këtë ekspeditë të egër morën pjesë edhe serbët lokalë. Banorët okularë (dëshmitarët), panë këta persona: Zoran Angjellkoviq me profesion veterinar, nga Gushica (Gashaj), Dragan Nikoliq, dentist, nga Gërnqari, Zhika (polic) nga Binça, Bora (polic i pensionuar) nga Vitia, Zvonko (polic) nga Mogilla, Nenad (polic) nga Gërnqari. Popullsia e paarmatosur, me forcë zhvendoset nga fshati, duke lënët ë gjitha. Me plaçka të pakta, që arritën t’i marrin nisën drejt malit të afërt, për ta kaluar kufirin për në Maqedoni. Sadistët serbë i nxorën nga shtëpia Muhamet Brahim Muharremin 32 vjeç, Xhavit Zenë Ademin 19 vjeç dhe Mustafë Beqir Shemën 33 vjeç. Në orën 13.30 minuta, i pushkatojnë te xhamia e fshatit. Ramadan Hajdarin 70 vjeç dhe Ahmet Jahi Ramën 20 vjeç i kidnapojnë diku afër kufirit me Maqedoninë, dhe i ekzekutojnë. Trupat pa jetë të të vrarëve u gjetën pas përfundimit të luftës, në një varrezë masive në Ferizaj. Beqir Ahmet Nura 80 vjeç paramilitarët serbë e dogjën brenda në shtëpi. I ndjeri ishte i sëmurë, thjeshtë palëvizshëm. Hajriz Brahim Brahimi (mentalisht i sëmurë), u masakrua afër kufirit me Maqedoninë më 16 prill. Në fshat u dogjën 28 shtëpi, të tjerat, u plaçkitën dhe u demoluan. Lubishta (Lugishta) në këtë luftë pati 9 banorë të vrarë, duke llogaritur ushtarin Sali Halim Zenunin i rënë dëshmor në malet e Pashtrikut, si dhe Kemajl Hamdi Azizin i vrarë në Vërban (Urban).
PS:
Emrat e të vrarëve janë dhënë nga Metush Metushi.

at June 22, 2014

No comments:

Post a Comment

Search This Blog
Search

- Home

About Me
Sabit
View my complete profile

Report Abuse

Labels
- kabashi

Blog Archive
- ► 2024 (1)
- ► 2023 (2)
- ► 2022 (1)
- ► 2021 (1)
- ► 2020 (2)
- ► 2019 (5)
- ► 2018 (31)
- ► 2017 (14)
- ► 2016 (24)
- ► 2015 (13)
- ▼ 2014 (56)
  - ► December (1)
  - ► November (11)
  - ► September (3)
  - ► August (1)
  - ► July (4)
  - ▼ June (24)
    - Nënë Lumja (proze)
    - QIELLIT TË SAJ (Nga libri me poezi “Kaq mall”)
    - E NATYRSHMJA NË ARTISTIKEN
    - Nga libri ditar “Ankthi i Pranverës ‘99”, Prishtin...
    - Aksioni në zyrën e Komandës partizane në Viti, dhj...
    - Less
    - Nga libri ditar “Ankthi i Pranverës ‘99”, Prishtin...
    - Marr nga libri “Ankthi i Pranveres ‘99”, Prishtinë...
    - Kurnaci
    - Dushkaja

To leave a comment, click the button below to sign in with Google.

SIGN IN WITH GOOGLE

Newer Post Home Older Post

Subscribe to: Post Comments (Atom)

rajonipress VITIASI SABIT ABDYLI KRIJON EDHE NGA MËRGATA Sabit Abdyli, është një krijues i dashur për lexuesit, njeri i lindur në rajonin ...

ANEKDOTA E MAHI

Eastern Beach (Auckland) ANI DADA SHAHE Vajzave, sipas traditës, kur shkonin nuse, tri ditë përpara i ngjitej boja n...

KABASHI HISTORI E SHKURTËR

Q Ë NDRESA Historia e Kabashit të Anamoravës dhe e themeluesve të tij është e bujshme, interesante dhe e dhimbshme. Kabashët u ve...

Portrete kabashësh që bënë histori

Adem Arif - Kabashi 1864-1910 Adem Arif - Kabashi 1864-1910 Ademi Arif Kabashi u lind në vitin 1866. U burrërua në famil...

Njeriu me ombrellë

Emigranti

AFËR LARG (prozë poetike)

Dy tregime me motiv nga lufta 1999

Cikël poezish marr nga libri “Kaq mall”

Fundi i perralles ...

Cikël poezish shkëputur nga libri “Kaq mall”

28 nëntor 2005, Flamuri shqiptar në valëzim të plo...

Vala hileqare

Pas 50 vjetësh e putha tokën nënë...

Inkuizicioni

Në dejtë e mi rrjedh gjak shqiptari

TRI VJET RRUGË DERI NË ZELANDË TË RE

Poezi të shkëputura nga libri “KAQ MALL”

► May (12)

Simple theme. Theme images by luoman. Powered by Blogger.